

## Kombetarja/ A do te rinovojne Duka dhe De Biasi ?!

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 16 Tetor 2013 20:32

---



Kombetarja kuqezi e ka nje trainer, por nese do ta kete per te ardhmen apo jo, kjo nuk dihet ende me siguri. Presidenti i FSHF-se Armando Duka ne te gjitha daljet e tij publike ka konfirmuar dhe pohuar publikisht oferten qe i ka bere teknikut italian Xhani De Biasi. Traineri ka pohuar ne gjuhen e tij ne konferencen e te merkures, se do te jete i Shqiperise. Palet kane rene dakord por ajo qe mungon eshte firma ne kontrate. Tifozet shqiptare e duan dhe presin me padurim rinovimin, por qe ai te vije duhet nenshkruar kontrata. A do te rinovojne De Biasi apo jo ne duhet te presim.